

L I G J
Nr.8231, datë 9.8.1997

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8001, DATË 22.9.1995 "PËR GENOCIDIN DHE
KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT KRYER NË SHQIPËRI GJATË SUNDIMIT KOMUNIST
PËR MOTIVE POLITIKE, IDEOLOGJIKE E FETARE", NDRYSHUAR ME LIGJIN
NR.8219, DATË 13.5.1997**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8001, datë 22.9.1995 "Për genocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike e fetare", ndryshuar me ligjin nr.8219, datë 13.5.1997, në nenin 3, në paragrafin e parë hiqen fjalët:

"zgjidhen paskëtaj deputetë në Kuvendin Popullor dhe kryetarë bashkie dhe as të".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.